

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sikaflex<sup>®</sup>-118 Extreme Grab

ADEZIV ELASTIK ME MBËRTHIM FILLESTAR SHUMË TË FUQISHËM

### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikaflex<sup>®</sup>-118 Extreme Grab është adeziv për ndërtimin me 1 përbërës dhe mbërthim fillestar shumë të lartë, i cili ngjit shumicën e nënshtresave të ndërtimit. Për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.

### PËRDORIMET

Një adeziv për ngjitjen e shumë përbërësve dhe materialeve të ndërtimit si:

- Beton
- Mure
- Shumicën e gurëve
- Qeramikat
- Dru
- Metale
- Qelq
- Pasqyra

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Mbërthim fillestar shumë i lartë
- Fiksim i objekteve të rënda pa fiksim të përkohshëm
- Punueshmëri e mirë
- Çlirime shumë të ulëta
- Adeziv-izolues me markë CE

### INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtueshmëri me LEED v4 EQc 2: Materiale me çlirime të ulëta
- Klasifikimi GEV-EMICODE EC 1 PLUS për çlirimet VOC
- Klasifikimi RTS M1 për çlirimet VOC të materialeve të ndërtimit
- Kategoria A+ sipas Rregullores Franceze rreth Çlirimeve VOC

### MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 15651-1 - Izolues për përdorim jostrukturor në fugat e ndërtesave - Elementëve të fasadave: Kategoria F EXT-INT CC 20HM

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Polimere terminale silani
Ambalazhi	Tubetë 290 ml, 12 copë/ kuti
Ngjyra	E bardhë, gri betoni, e zezë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +25°C. Referohuni gjithmonë tek ambalazhi.
Dendësia	~1,40 kg/l (ISO 1183-1)

## TË DHËNA TEKNIKE

Fortësia Shore A	~50 (pas 28 ditësh)	(ISO 868)
Rezistenca ndaj tërheqjes	~2,2 N/mm <sup>2</sup>	(ISO 37)
Zgjatimi deri në thyerje	~350 %	(ISO 37)
Rezistenca ndaj përhapjes së grisjes	~10,0 N/mm	(ISO 34)
Temperatura e funksionimit	-40 °C min. / +80 °C max.	

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Rendimenti	<b>Rendimenti (1 tubetë 290 ml)</b>	<b>Përmasa</b>
	~100 pika ~5 m kordon [1]	Diametri = 30 mm Trashësia = 4 mm Maja e tubetit e prerë në formë V-je, kordon në formë trekëndore (~60 ml për meter linear)
[1] Shënim: Për objekte të rënda ose kordona adezivi me trashësi më të madhe mund të nevojiten deri në ~120 ml për meter linear.		
Rrjedha e varjes	0 mm (profil 20 mm, 23 °C)	(ISO 7390)
Temperatura e mjedisit	+5 °C min. / +40 °C max.	
Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +40 °C max., min. 3°C mbi temperaturën e pikës së vesës	
Ritmi i maturimit	~3 mm/24 orë (23°C / 50% lagështi relative)	Sika Corporate Quality Procedure (CQP 049-2)
Koha e krijimit të kores	~15 min (23°C / 50% lagështi relative)	(CQP 019-1)

## UDHËZIME APLIKIMI

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, e pastër, e thatë dhe pa ndotje si vaji, graso, kore çimentoje (qumësht), izolues të vjetër dhe veshje boje të vjetra të cilat mund të ndikojnë në ndërkapjen e adezivit. Për ndërkapje optimale dhe për aplikimet kritike dhe me performance të lartë duhet të ndiqen procedurat e mëposhtme të lyerjes me prajmer apo trajtimit paraprak:

#### Nënshtresa joporoze

Alumini, alumini i anodizuar, çeliku i pandryshkshëm, çeliku i galvanizuar, metalet e veshura me pluhur ose pllakat me glazurë duhet të smerilizohen. Pastroni dhe trajtoni paraprakisht duke përdorur Sika® Aktivator-205 mbi një pecetë të pastër.

Përpara ngjitjes/izolimit, lini kohë pritjeje > 15 minuta (< 6 orë).

Metalet e tjera si bakri, tunxhi dhe titanium-zinku duhet të pastrohen dhe të trajtohen paraprakisht me Sika® Aktivator-205 me një pecetë të pastër. Pas kohës së pritjes prej > 15 minutash (< 6 orë) aplikoni Sika® Primer-3 N me furçë. Lini një kohë shtesë prej > 30 minutash (< 8 orë) përpara ngjitjes / izolimit.

PVC-ja duhet të pastrohet dhe të trajtohet paraprakisht me Sika® Primer-215 të aplikuar me një furçë. Lini kohë pritjeje prej > 15 minutash (< 8 orë) përpara ngjitjes / izolimit.

#### Nënshtresa poroze

Betoni, aerobetoni dhe suvatë me bazë çimentoje, llaçet dhe tullat duhet të lyhen me Sika® Primer-3 N të aplikuar me furçë.

Përpara ngjitjes/izolimit, lini kohë pritjeje prej > 30 minutash (< 8 orë). Për më shumë këshilla dhe udhëzime të detajuara kontaktoni me shërbimin teknik të Sika-s.

Shënim: Prajmerat janë përforcues të ngjitjes dhe jo një alternativë për përmirësimin e përgatitjes së dobët/pastrimit të sipërfaqeve të fugave. Prajmerat përmirësojnë gjithashtu performancën e ngjitjes afatgjatë të një fuge të izoluar.

### METODA E APLIKIMIT / MJETET

#### Procedura e ngjitjes

Pas përgatitjes së nevojshme të nënshtresës, përgatitni majën e tubetës përpara ose pasi t' a keni vendosur tek pistoletat. Vidhosni majën tek tubeta. Nxirrni Sikaflex®-118 Extreme Grab në kordona trekëndorë, shirita ose pika në distancë disa centimetra nga njëra-tjetra. Ushtroni forcën e dorës për të fiksuar në pozicion elementët që do të ngjiten përpara se adezivi të krijojë kore. Elementët e vendosur në pozicionin e gabuar, mund të shkëputen me lehtësi dhe të ripozicionohen gjatë minutave të para pas aplikimit. Nëse nevojitet, përdorni përkohësisht shirita adezivë, pyka ose suporte për të mbajtur së bashku pjesët e montuara gjatë kohës fillestare të tharjes.

Adezivi i freskët dhe i patharë që mbetet mbi sipërfaqe

duhet të hiqet menjëherë. Rezistenca përfundimtare do të arrihet pas tharjes së plotë të Sikaflex®-118 Extreme Grab, p.sh. pas 24 deri 48 orësh në +23°C, në varësi të kushteve të mjedisit dhe trashësisë së shtresës së adezivit.

## MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit menjëherë pas përdorimit me Sika® Remover-208. Pas tharjes, materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

Për pastrimin e lëkurës përdorni pecetat Sika® Cleaning Wipes-100.

## DOKUMENTA SHITESË

- Tabela e trajtimit paraprak për ngjitjen dhe izolimin

## KUFIZIME

- Për punueshmëri të mirë, temperatura e adezivit duhet të jetë +20°C.
- Nuk rekomandohet aplikimi gjatë ndryshimeve të larta të temperaturës (lëvizje gjatë tharjes).
- Përpara ngjitjes, kontrolloni ndërkapjen dhe rezistencën e bojërave dhe veshjeve duke kryer një provë.
- Sikaflex®-118 Extreme Grab mund të lyhet me shumicën e sistemeve të veshjeve dhe bojërave konvencionale me bazë uji. Megjithatë, duhet të sigurohet kompatibiliteti i bojërave duke kryer testime paraprake. Përftohen rezultate më të mira të lyerjes pas tharjes së adezivit. Shënim: sistemet jofleksibël të bojërave mund të dëmtojnë elasticitetin e adezivit dhe të shkaktojnë plasaritje të cipës së bojës.
- Mund të ndodhin ndryshime të ngjyrës për shkak të ekspozimit ndaj kimikateve, temperaturave të larta dhe/ose rrezatimit UV (sidomos në ngjyrën e bardhë). Megjithatë, ndryshimi i ngjyrës është totalisht i natyrës estetike dhe nuk ndikon negativisht në performancën teknike apo qëndrueshmërinë e produktit.
- Përdorni gjithmonë Sikaflex®-118 Extreme Grab në kombinim me fiksues mekanikë për aplikimet tavanore ose objektet e rënda.
- Për përbërës shumë të rëndë, vendosni suport të përkohshëm derisa Sikaflex®-118 Extreme Grab të thahet plotësisht.
- Aplikimet / fiksime të gjithë sipërfaqes nuk rekomandohen, pasi pjesa e brendshme e shtresës së adezivit mund të mos thahet kurrë.
- Përpara përdorimit të Sikaflex®-118 Extreme Grab mbi gurin natyror, kontaktoni me shërbimin teknik të Sika-s.
- Mos përdorni Sikaflex®-118 Extreme Grab mbi nënshtresa bituminoze, gomë natyrore, gomë EPDM ose mbi çdo material ndërtimi prej të cilit mund të rrjedhin vajra, plastifikues apo tretës të cilët mund të sulmojnë adezivin.
- Mos përdorni Sikaflex®-118 Extreme Grab mbi polietilen (PE), polipropilen (PP), politetrafluoroetilen (PTFE / Teflon) dhe disa materiale sintetike të plastifikuara. Duhet të kryhen testime paraprake ose

kontaktoni me shërbimin teknik të Sika-s.

- Mos përdorni Sikaflex®-118 Extreme Grab për ngjitje qelqi nëse vija e ngjitjes ekspozohet në rrezatim diellor.
- Mos përdorni Sikaflex®-118 Extreme Grab për ngjitje strukturore.
- Mos ekspozoni Sikaflex®-118 Extreme Grab e patharë ndaj produkteve me përmbajtje alkooli, pasi kjo gjë do të ndikojë në reaksionin e tharjes.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

**Sika Albania SHPK**

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sikaflex®-118 Extreme Grab  
Gusht 2019, Botimi 06.01  
02051302000000046

Sikaflex-118ExtremeGrab-sq-AL-(08-2019)-6-1.pdf

